

BRIF MUJOR

tetot 2016

Monitorimi i qeverisjes të rritjes në fushën e drejtësisë nga Strategjia për Evropën Juglindore 2020 (JuDGMeNT)

Pasqyra mujore publikohet në kuadër të Projektit “Monitorimi i qeverisjes të rritjes në fushën e drejtësisë nga Strategjia për Ejl 2020 (JuDGMeNT)”, të cilin e zbaton Instituti për Politikë Evropiane, me mbështetje financiare të Këshillit Rajonal për Bashkëpunim. Qëllimi kryesor i Projektit është vendosja e mekanizmit të strukturuar nga organizatat qytetare për monitorimin e përmbushjes së masave/instrumenteve/prioriteteve nga dimensionimi *Drejtësi*, konform Strategjisë së Ejl 2020. Këto masa janë:

P.1. Përmirësimi i efikasitetit dhe kompetencës: pasqyra e cilësisë, efikasitetit dhe kompetencës të gjyqtarëve dhe gjykatave;

P.2. Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor sa i përket qasjes së lirë deri te informacionet, zbatimi i ekzekutimeve ndërkufitare dhe procedurave ndërkufitare sa i përket falimentimit, transferimit dhe bashkimit;

P.3. Mbështetje të zgjidhjes alternative të kontesteve (ZAK): Inkorporimi ose përmirësimi i kornizës ligjore për ZAK dhe ofrimi i bashkëpunimit përkatës juridik dhe institucional me sistemin gjyqësor dhe me sistemin e zbatimit.

Për më shumë informacione për Projektin vizitoni linkun në vijim:
http://www.epi.org.mk/newsDetail_mk.php?nwsid=131.

Cilësia, kompetenca dhe efikasiteti i gjyqtarëve dhe gjyqësorit

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë

Më datë 28.10.2016, në organizim të Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë dhe Institutit CEELI nga Praga, në Ohër u mbajt Konferenca ndërkombëtare për pavarësinë e gjyqësorit me temë: “Gjyqësori i pavarur”. Në këtë Konferencë u përfshinë temat si vijojnë: sfidat, praktikat dhe përvojat e mira për një gjyqësor të pavarur lidhur me aspektin e pavarësisë së legjislacionit, pavarësisë financiare dhe funksionale; mbështetje të perceptimeve pozitive për gjyqësorin dhe respektimi i pavarësisë së tij; edukimi i vazhdueshëm dhe etika gjyqësore; gjyqësori transparent dhe marrëdhëniet me mediat. Në këtë Konferencë morën pjesë kryetarët e gjykatave supreme, të apelit dhe të gjykatave themelore, anëtarët e shoqatave të gjyqtarëve



dhe ekspertë juridikë nga Maqedonia, Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Gjeorgjia, Lituania, Polonia, Sllovenia, Kroacia, Çekia dhe SHBA.¹

Sistemi gjyqësor i RM

Gjatë muajit tetor, Këshilli Gjyqësor mbajti 2 seanca në të cilat, mes tjerash, u formua Komisioni për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores së Punës të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe Komisioni për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për ngritjen dhe përcaktimin e humbjes së përhershme të aftësisë për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Njëherësh, Këshilli Gjyqësor mori vendim për ndërprerjen e funksionit të 1 (një) gjyqtari për shkak të mbushjes së moshës 64 vjeçare, vendim për zgjedhjen e 1 (një) gjyqtari nga radhët e kandidatëve nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, vendim lidhur me kundërshtimin e gjyqtarit, vendim për ndërprerjen e funksionit gjyqtar – porotë në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup sipas propozim-listës së Kryetarit të Gjykatës dhe i është dhënë pëlqim për ligjërues në Universitet gjyqtarit të Gjykatës Themelore të Kavadarci. Veç tjerash, u shqyrtuan dhe miratuan raportet për punën e gjykatave në Republikën e Maqedonisë për tremujorin e dytë të vitit 2016.²

Më datë 14.10.2016, Këshilli Gjyqësor i RM shpalli konkurs për zgjedhjen e kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup dhe për zgjedhjen e 1 (një) gjyqtari të Gjykatës së Apelit në Manastir për çështje civile.

Më datë 20.10.2016, Këshilli Gjyqësor i RM mbajti konferencë për shtyp në temën: “Mbrojtja e pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe ruajtja e reputacionit dhe dinjitetit të gjyqtarëve”. Qëllimi i kësaj konference për shtyp, siç u komunikua nga njeriu i parë i Këshillit, është ruajtja e integritetit, si dhe të stimulohet vetëdija publike për presionet dhe influencën aktuale mbi gjyqësorin. U theksua se mediat kanë ushtruar presion mbi kastën e gjyqtarëve. Kryetari i Këshillit dha sqarime se madje janë ndjerë të rrezikuar me atë që PSP i ka thirrur në seancë dëgjimore pesë gjyqtarë nga Gjykata Administrative.³ T’ju përkujtojmë, ky nuk është rasti i parë në të cilin akuzohen gjyqtarë. Paraprakisht, Prokuroria për Krim të Organizuar akuzoi dhe arrestoi rreth dhjetë gjyqtarë, por Këshilli Gjyqësor nuk reagoi për këtë rast.

Delegacione të Këshillit Gjyqësor, gjatë muajve të kaluar, realizuan vizita studimore në Oslo, në Mbretërinë e Norvegjisë si dhe në Vulkanus, Republika e Lituanisë, në kuadër të një delegacioni më të gjerë nga institucionet kompetente.

Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë

Deri në këtë moment nuk ka informacione lidhur me fillimin e trajnimit të gjeneratës së gjashtë të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.

¹<http://www.vsrn.mk/Novosti.aspx?novost=129>

² Komunikatë nga seanca e 235 nga data 7.10.2016 <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=459>

³ Komunikatë nga konferenca për shtyp e datës 20.10.2016 година,

<http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novost=464>;

Karaxhovski u ankua nga presioni i mediave mbi gjykatën <http://meta.mk/karadhovski-se-pozhali-na-pritisok-od-mediumite-vrz-sudot/>

- Përndryshe, Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë gjatë muajit tetor organizoi më shumë trajnime në kuadër të trajnimit të vazhdueshëm të detyrueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë publikë.⁴ Me fjalë të tjera, u organizuan këshillime në këto tema: “Terminologjia juridike dhe praktikimi i drejtshkrimit në vendimet gjyqësore dhe prezantimi i e-bazës së akteve normative dhe botimeve të Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”; “Kriteret e përcaktimit të kompensimit të dëmit në përputhje me Ligjin për përgjegjësi qytetare për ofendim dhe shpifje/Ligjin për media dhe përgjegjësi për ofendim dhe shpifje përmes internetit”; “Zbatimi praktik i Ligjit për përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së dënimit”; “Bashkëpunimi ndërkombëtar në materien civile”; “Zbatimi i Rregullores gjyqësore”; “Përdorimi i data bazave të praktikës gjyqësore evropiane për të drejtat e njeriut”. U mbajtën edhe këto trajnime: “Veprime hetimore/Hetim efektiv” dhe “Barra e provës/prova dhe kundërshtime” (në bashkëpunim me Misionin Monitorues të OSBE në Shkup), trajnim për Udhëzuesin praktik për gjyqtarë, personelin gjyqësor, prokurorët dhe avokatët lidhur me praktikën rrjedhëse gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sa i përket Nenit 5 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, si dhe trajnim në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të fokusuar mbi përgatitjen më të mirë të lëndëve para GJEDNJ dhe pranueshmërinë e ankesës, që u mbajt në kuadër të Tuining Projektit: “Përforcimi i sundimit të së drejtës” midis Republikës së Lituanisë dhe Republikës së Maqedonisë.

Monitorimi i procedurave gjyqësore⁵

Gjatë muajit tetor gjykatat punonin me orar të rregullt. Në këtë periudhë u ngritën dy hetime të reja nga ana e PSP “Toplik”⁶ dhe “Tenderë”⁷. Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup i thërriti të dy personat e dyshuar në lëndën “Tenderë” dhe pas përfundimit të seancës dëgjimore gjyqtari i procedurës paraprake me aktvendim nga data 28.10.2016 e hodhi poshtë propozimin e PSP si të pabazuar lidhur me përcaktimin e masës së kujdesit.⁸ Sa i përket lëndës “Lagjja e trimave”⁹ u mbajtën dy seanca gjyqësore në të cilat nxirreshin prova,

⁴ <http://www.jpacademy.gov.mk/upload/KATALOZI/PLAN%20NA%20OBUKI%20%209-12%202016%20123.pdf>

⁵ Nga monitorimi i rregullt i procedurave gjyqësore të Koalicionit “Të gjithë për gjykim të drejtë”

⁶ Në lëndën “Toplik” janë të dyshuar gjashtë persona të cilët përmes abuzimit të detyrës zyrtare dhe shkeljes së Ligjit për prokurime publike kanë kryer vepra penale me të cilat e kanë dëmtuar buxhetin në lartësi prej 1 milion e 44.000 euro. Shih më shumë në: <http://www.akademik.mk/toplik-i-tender-novi-predmeti-na-sjo-za-zloupotreba-na-sluzhbena-polozhba-i-ovlastuvana-vo-ministerstvoto-za-transport-i-vrski-i-ministerstvoto-za-kultura/>

⁷ Në lëndën “Tender” personi i dyshuar i parë, në pozitë udhëheqëse në Ministrinë e Kulturës, pa respektimin e Ligjit për prokurime publike dhe pa zbatimin e ankandit publik ka lidhur kontratë me realizuesin e aktiviteteve plotësuese ndërtimore në Muzeun e VMRO. Shih më shumë në: <http://www.akademik.mk/toplik-i-tender-novi-predmeti-na-sjo-za-zloupotreba-na-sluzhbena-polozhba-i-ovlastuvana-vo-ministerstvoto-za-transport-i-vrski-i-ministerstvoto-za-kultura/>

⁸ 31.10.2016 KOMUNIKATË PËR PUBLIKUN - <http://oskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=571>

⁹ Lënda “Lagjja e Trimave” është ngritur kundër 29 personave, pjesë e të ashtuquajturit “Grupi i Kumanovës” të cilët akuzohen për terrorizëm dhe organizatë terroriste për ngjarjet në lidhje me ndodhitë të datës 9 dhe 10 maj në “Lagjen e Trimave” në Kumanovë. Rasti më vonë u bashkua me “Vetëtimin” (“Molnja”) në të cilën zhvillohet procedurë kundër tetë personave të cilët e kanë ndihmuar grupin e armatosur nga “Lagjja e Trimave”.

Më datë 9 dhe 10 maj 2015 në “Lagjen e Trimave” në Kumanovë grupi i armatosur u konfrontua me forcat e sigurisë. Gjatë shkëmbimit të zjarrit jetën e humbën tetë policë të njësisve speciale dhe të veçanta të MPB, ndërsa rreth katërmëbëdhjetë morën plagë të rënda. U vranë edhe dhjetë persona

ndërsa të gjitha seancat e tjera gjatë muajit tetor u shtynë me qëllim që t'i sigurohet kohë e mjaftueshme mbrojtjes për shqyrtimin e provave, ndërkaq 2 seancat e fundit gjyqësore u shtynë për shkak të mungesës zyrtare të prokurorit publik.

Përmirësimi i bashkëpunimit gjyqësor lidhur me qasjen e lirë deri te informacionet, zbatimin e procedurave ndërkufitare lidhur me falimentimin, bashkëngjitjen dhe bashkimin

Më datë 3 tetor 2016 u mbajt konferenca për shtyp e partisë politike “Levica” lidhur me funksionimin e BEG, operatori i ngrohjes termike në Republikën e Maqedonisë. “Levica” bën tentativa ta zbuloj strukturën pronësore të BEG si një fakt i cili në mënyrë plotësuese e ngarkon faktin e, sipas tyre, abuzimit të padrejtë të një numri të madh të konsumatorëve të BEG. Ky është edhe një shembull i monitorimit të sjelljes së shoqërisë e cila është formuar në Maqedoni si rezultat i transaksionit afarist ndërkufitar. Siç është konstatuar edhe deri më tani, monitorimi bëhet nga aspekti i mbrojtjes së interesave specifike të një grupi të caktuar të palëve të interesuara, në këtë rast të konsumatorëve të shoqërisë.¹⁰

Mbështetja e ZAK: Inkorporimi ose përmirësimi i kornizës ligjore për ZAK dhe mundësimi i bashkëpunimit përkatës juridik dhe institucional me sistemin gjyqësor dhe sistemin e zbatimit

Gjatë muajit tetor, në fushën e ndërmjetësimit, si mënyrë e ZAK, vazhdoi veprimi aktiv i ndërmjetësuesve të licencuar¹¹ për lëndët e iniciuara me kërkesë të palëve të interesuara, konform ndryshimeve të Ligjit për procedurë kontestimore sipas të cilave, për disa konteste të caktuara ekonomike përpjekja për ndërmjetësim është e detyrueshme. Është me rëndësi të theksohet se janë iniciuar dy procedura të ndërmjetësimit kryesisht të bazuara në parimin e vullnetarizmit. Inicimi i procedurave të këtilla për të cilat tentativa nuk është e detyrueshme gjithsesi se është një hap që duhet përshëndetur në drejtim të avancimit të ndërmjetësimit e që e vë në dukje ndryshimin e perceptimit të qytetarëve sa i përket këtij lloji të zgjidhjes alternative të kontesteve në drejtim pozitiv.

nga grupi i armatosur. Shih më shumë në:
<http://prizma.birn.eu.com/%D0%BC%D0%BA/%D1%81%D1%82%D0%BE%D1%80%D0%B8%D0%B8/%D0%BF%D0%BE%D1%87%D0%BD%D1%83%D0%B2%D0%B0-%D1%81%D1%83%D0%B4%D0%B5%D1%9A%D0%B5%D1%82%D0%BE-%D0%B7%D0%B0-%D0%BA%D1%83%D0%BC%D0%B0%D0%BD%D0%BE%D0%B2%D1%81%D0%BA%D0%BE-%D0%B4%D0%B8%D0%B2%D0%BE-%D0%BD%D0%B0%D1%81%D0%B5%D1%99%D0%B5>

¹⁰ <http://www.brif.mk/parite-od-beg-odat-na-privatni-smetki-na-vmro-dpmne-vo-kipar-obvini-levitsa/>

¹¹ http://www.justice.gov.mk/documents/medijatori_2.pdf

Gjatë muajit tetor kanë përfunduar 10 lëndë të ndërmjetësimit. Prej tyre, 6 lëndë kanë përfunduar me ujdi me të cilën kontesti është zgjidhur, në një lëndë ka filluar ndërmjetësimi aktiv, megjithatë procesi është ndërprerë për shkak të heqjes dorë të njëres nga palët, kështu që procedura ka përfunduar pa sukses, ndërsa në 3 lëndë, procedura e ndërmjetësimit ka përfunduar në tentativë, përkatësisht thirrjes të dërguar nga pala e kundërt nuk i është përgjigjur në mënyrë pozitive për fillimin e negociatave për zgjidhjen e kontestit.¹²

Ndërmjetësuesit organizuan disa takime konsulce në ambientet e Asociacionit për Mbështetjen e Ndërmjetësimit pranë Dhomës Ekonomike të Maqedonisë me qëllim të organizimit të ngjarjeve promovuese para sektorit të biznesit në mënyrë që ta afrojnë ndërmjetësimin deri te personat juridikë, me ç'rast kanë rënë dakord që të organizohen pesë seminare njëditore pa pagesë në disa qytete të Maqedonisë në periudhën e ardhshme.¹³

Ministria e Drejtësisë, më datë 10.10.2016, publikoi një njoftim për dhënien e provimit për ndërmjetësues në sesionin e nëntorit¹⁴. U paraqitën gjithsej 21 kandidatë që e vë në dukje faktin se interesimi për fitimin e licencës për ndërmjetësues është shumë i madh.

Sa u përket aktiviteteve të tjera për muajin tetor, mund ta apostrofojmë pjesëmarrjen e disa ndërmjetësuesve të licencuar nga Maqedonia në Konferencën e Parë Ndërkombëtare të Ndërmjetësuesve nga Evropa Juglindore “Ndërmjetësimi dhe zhvillimi i komunikimit” e cila u mbajt më datë 22.10.2016 në Zagreb¹⁵. Në këtë Konferencë morën pjesë ndërmjetësues nga Kroacia, Republika e Maqedonisë, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia.¹⁶ Pjesëmarrësit e Konferencës nga shtete të ndryshme arritën një pajtim të ndërsjellë për formimin dhe regjistrimin e Shoqatës së Ndërmjetësuesve të Evropës Juglindore e cila do ta ketë selinë në Zagreb, Republika e Kroacisë.

Nga fusha e zgjidhjes me ujdi të kontesteve të punës, gjatë muajit tetor të vitit 2016 u mbajtën tri konferenca në Republikën e Maqedonisë, prej të cilave dy konferenca ndërkombëtare dhe një nacionale. Së këtejmi, në Ohër, nga data 18 deri më 19 tetor të vitit 2016, u mbajt Konferenca ndërkombëtare me titull: “Konferencë sub-rajonale e nivelit të lartë për mekanizmat efektivë të zgjidhjes së kontesteve të punës”, në organizim të Organizatës Ndërkombëtare të Punës pranë KB, Projekt i financuar nga BE. Në këtë Konferencë morën pjesë drejtorë, pajtues dhe arbitra nga Maqedonia, Bullgaria, Serbia, Mali i Zi, Republika Serbska, Kosova, Shqipëria dhe Hungaria. Mes tjerash, u konstatua se 41 persona janë licencuar për arbitër dhe pajtues në Republikën e Maqedonisë.

Më datë 19 tetor të vitit 2016, u mbajt Konferenca e Parë Nacionale e arbitrave dhe pajtuesve për konteste të punës në Republikën e Maqedonisë. Konferenca mbante këtë titull: “Çështje aktuale nga fusha e pajtimit dhe arbitrazhit në Republikën e Maqedonisë”.¹⁷ Në këtë Konferencë u nënvizua nevoja e harmonizimit më të madh midis Ligjit për zgjidhjen

¹² Të dhëna nga Regjistri i MD dhe informacione nga ndërmjetësuesit

¹³ [http://www.mchamber.mk/\(S\(f4kszh45tlpxrd32madzmi55\)\)/default.aspx?lId=1&mId=55&evId=34008](http://www.mchamber.mk/(S(f4kszh45tlpxrd32madzmi55))/default.aspx?lId=1&mId=55&evId=34008)

¹⁴ <http://www.justice.gov.mk/documents/ispit%20za%20medijatori%20noemvriska2016.pdf>

¹⁵ www.medijator.com

¹⁶ <http://medijator.com/program-1-konferencije-medijatora-jie-zagreb-2016/>

¹⁷ Raporti i Asociacionit të pajtuesve dhe arbitrave të kontesteve të punës në Republikën e Maqedonisë

me ujdj të kontesteve të punës, Ligjit për ndërmjetësim në RM, si dhe Ligjit për marrëdhënie të punës.

Më datë 20.10.2016 në Ohër u mbajt Konferenca ndërkombëtare me titull: "Takimi i parë vjetor i Rrjetit sub-rajonat të agjencive për zgjidhjen miqësore të kontesteve të punës". Vëmendje e veçantë iu përkushtua më shumë temave në lidhje me kontestet e punës, ndërkaq u prezantua një pasqyrë e kornizës rajonale ligjore për zgjidhjen me ujdj të kontesteve të punës në rajon, ose më saktë në Maqedoni, Serbi, Republika Serbska, Mal të Zi dhe Bullgari. Në kuadër të kësaj Konference u prezantua edhe sistemi i platformës virtuale "ESAP" e cila duhet të shërbejë si data bazë rajonale në lidhje me zgjidhjen me sukses të kontesteve të punës.

Që të tria konferencat u mbuluan nga mediat, me informata për ngjarjen, si dhe me transmetime të intervistave të shkurtra nga televizionet me koncesione nacional dhe nga televizioni rajonal i Ohrit.

